



DHUNA NDAJ FËMIJËVE NË SHQIPËRI

Raport i të dhënave të ALO 116 për periudhën 2009 - 2014

Tiranë, 2014



PËRMBAJTJA

1. Hyrje	3
2. Raportimet e fëmijëve mbi dhunën	4
- Abuzimi Fizik	5
- Abuzimi Emocional	7
- Abuzimi Seksual	10
- Neglizhimi	12
3. Dhuna ndaj fëmijëve në shkollë	15
- Bulizmi	
- Problemet me mësuesit	
4. Problemet e fëmijëve në mjedisin familjar	18
5. Sfida dhe Rekomandime	21

1. Hyrje

Ky raport pasqyron situatën aktuale mbi format e dhunës të ushtruar ndaj fëmijëve të raportuara në vite në ALO 116 nga fëmijë dhe të rritur. Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë synon të evidentojë të gjitha shqetësimet, problematikat dhe shkeljet e të drejtave të fëmijëve të raportuara nga vetë ata. Një ndër çështjet më shqetësuese të cilës duhet t'i kushtojmë një vëmendje shumë të madhe është ushtrimi i dhunës dhe neglizhimi ndaj fëmijëve.

ALO 116, që prej vitit 2009 është shërbim kombëtar i telefonisë për mbrojtjen e fëmijëve, që i asiston ata në momentet më të vështira të jetës. Që nga themelimi, ALO 116 kanë marrë përgjigje më shumë se **530,585 telefonata**, prej të cilave, janë trajtuar **13.112 raste** nga e gjithë Shqipëria.

ALO 116 – Linja Kombëtare e Telefonit të Ndihmës për Fëmijë komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: **ALO 116 111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë; ALO 116 000 – Linja e Telefonit për Fëmijët e Humbur**. ALO 116 mbështetet nga zyra e UNICEF- Shqipëri dhe CRCA si dhe kompanitë e telefonisë së lëvizshme: Amc, Vodafone, Eagle mobile, Plus dhe ALBtelecom.

ALO 116 operon 24 orë, në 7 ditë të javës në dispozicion të fëmijëve dhe adoleshentëve anëmbanë vëndit. Shërbimet kryesore që ofron ALO 116 janë: këshillim psikosocial nëpërmjet telefonit, informacionit për çështjet që fëmijët i konsiderojnë thelbësore për jetën e tyre si dhe referon kërkesat e tyre sipas nevojave që ata përcjellin pranë shërbimit.

ALO 116 tashmë është një shërbim që e ka formësuar dhe konsoliduar pozicionin e saj, si një partner i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen dhe të drejtave të fëmijëve në vend. Gjithashtu shërbimi i ALO 116 ka krijuar një eksperience dhe praktikë pozitive në forcimin sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke bashkëpunuar me institucione dhe organizata partnere në lidhje me çështjet që afektojnë direkt mirëqenien e fëmijëve në Shqipëri.

Më gjërësisht në këtë raport ne do të sjellim në vëmendjen tuaj tematikën e dhunës, si një ndër shqetësimet më aktuale që prek drejtpërsëdrejti fëmijët. Ky raport është i organizuar në tre pjesë kryesore. Së pari, nga raportimet e fëmijëve është bërë një përmbledhje e formave të dhunës të ushtruar ndaj tyre në mjedise të ndryshme. Së dyti, raporti trajton rastet e dhunës ndaj fëmijëve në mjediset e shkollës. Së treti, pasqyrohen problematikat më të shpeshta që hasin fëmijët në mjedisin familjar.

Në përfundim të këtij raporti, evidentohen disa prej sifidave më aktuale që fëmijët ndeshin në realitetin ku ata jetojnë. Në përgjigje të ketyre sfidave ALO 116 rekomandon mekanizma ndërhyrës për një mbrojtje dhe kujdesje më të mirë për fëmijët.

Rezearta Gjalpi

Menaxhere e Përgjithshme e ALO 116

Raportimet e fëmijëve mbi dhunën

2009 - 2014

2. Raportimet e fëmijëve mbi dhunën në Shqipëri

2.1 Përkufizimet për dhunën ndaj fëmijëve

Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon dhunën si: Përdorim të qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim.

(OBSh, 1999&2002)

Dhuna ndaj fëmijëve sipas nenit 19 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës përfshin të gjitha format e dhunës fizike ose psikologjike, lëndimin dhe abuzimin, neglizhencën ose trajtimin neglizhues, keqtrajtimin ose shfrytëzimin përfshirë dhe abuzimin seksual.

(Neni 19 i KDF)

2.2 ALO 116 dhe raportimet e fëmijëve mbi dhunën

Gjatë këtyre viteve në shërbimin ALO 116 janë raportuar disa nga format më të shpeshta të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve. Ky raport pasqyron fakte dhe të dhëna nga fëmijët mbi format e dhunës dhe mjediset në të cilët ata janë më të ekspozuar. Me profesionalizëm, këshilluesit e shërbimit kanë njohur dhe identifikuar të gjitha format e dhunës, si përsëmbull, abuzimin fizik, emocional dhe seksual. Në rastet e referuara ka pasur edhe çështje që lidhen me neglizhimin, si një formë e mosplotësimit të nevojave të fëmijëve.


Parimet kryesore të punës së ALO 116 janë:

- Ne i përgjigjemi çdo telefonate 24 orë në 7 ditë të javës;
- Ne i shërbejmë fëmijëve dhe të rinjëve në nivel kombëtar;
- Ne ofrojmë këshillim dhe ndihmë për çdo fëmijë;
- Ne ofrojmë sandartet më të mira të shërbimit për fëmijët dhe të rinjtë;
- Ne referojmë çdo rast, që kërkon zgjidhje, pranë shërbimeve publike dhe private të mbrojtjes së fëmijës;
- Ne luftojmë për të garantuar në punën tonë standardet më të larta dhe më profesionale të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë;
- Ne besojmë se çdo fëmijë dhe i ri, pavarësisht moshës apo aftësisë, gëzon të drejta të barabarta dhe ai është i aftë të identifikojë dhe shprehet për problemet që e shqetësojnë;
- Ne punojmë që të bëjmë të mundur pjesëmarrjen e fëmijëve;
- Ne jemi të aksesueshëm për fëmijët dhe të rinjtë edhe në forma të tjera alternative komunikimi, si nëpërmjet internetit apo shërbimeve postare;


2.3 Abuzimi fizik

M.L" Babi gjithmonë më ofendon dhe qëllon para shokëve të lagjes. Ndihej keq për këtë situatë sepse edhe shokët kanë filluar të më tallin"

Në një periudhë prej 6 vjetësh, ALO 116 ka trajtuar **3643** çështje të dhunës dhe problematikat që fëmijët kanë ndeshur në mjedise si familja, shkolla dhe komuniteti. Nga raportimet e marra **528** raste që i referohen abuzimit fizik. Referuar këtyre të dhënave djemtë përbëjnë numrin më të madh të raportuara me **52%** të rasteve, ndërsa vajzat përbëjnë **48 %** të rasteve të trajtuara në shërbimin ALO 116.



Ushtruesit e dhunës



Familjarët, mësuesit apo bashkëmoshatarët vazhdojnë të influencojnë në krijimin e një mjedisi jo të sigurt e të shëndetshëm për fëmijët. Abuzimin fizik ndryshe ne do ta cilësojmë si një ndër format e dhunës e cila ndodh pas dyerve të mbyllura.


Të dhënat e pasqyruara në grafik tregojnë se djemtë kanë raportuar më tepër raste të dhunës fizike sesa vajzat.

Nga raportimet e marra fëmijët tregojnë se ushtruesi më i shpeshtë i dhunës fizike në shtëpi është nëna me **22%** të rasteve të raportuara, ndërsa ushtruesi më i ashpër është babi me **27%** të rasteve të raportuara në shërbimin ALO 116.

Vënia në përdorim të shpullave, çokut, grushtit, shqelmit apo edhe sendeve për të ndëshkuar fëmijën është një tregues i karakterit të dhunës fizike në shtëpi dhe i ashpërsisë me të cilën ajo vazhdon të shfaqet.

Nga të dhënat e marra në shërbimin ALO 116, fëmijët raportojnë se mësuesit në shkollë vazhdojnë ta përdorin dhunën fizike si një mjet disiplinimi në orët mësimore. Nuk mungojnë edhe rastet kur fëmijët e konsiderojnë dhunë fizike nd si një menyrë për të zgjidhur situatat konfliktuale midis tyre.

Shpërndarja gjeografike




Shpërndarja gjeografike e telefonatave të raportuara për rastet e abuzimit fizik pranë shërbimit ALO 116 në nivel qarku janë evidentuar kryesisht: Peshkopia me **81** raste të raportuara, Tirana me **78** raste, Elbasani me **52** raste etj.


2.4 Abuzimi emocional

E.A “Prindërit e mi asnjëherë nuk janë të kënaqur me atë që unë bëj, më bërtasin shpesh dhe më cilësojnë si i “pavlerë” dhe kjo gjë më bënë të ndihem keq.”

Gjatë 5 viteve të punës së ALO 116 janë trajtuar gjithsej **193** raste që i referohen abuzimit emocional. Referuar këtyre të dhënave vajzat përbëjnë numrin më të madh të raportuara me **60%** të rasteve ndërsa djemtë me **40 %** të rasteve të trajtuara në shërbimin ALO 116.



Ushtruesit e dhunës



Të dhënat e pasqyruara në grafik tregojnë se vajzat kanë raportuar më tepër raste të dhunës psikologjike sesa djemtë në shërbimin ALO 116.

Nga rastet e trajtuara fëmijët tregojnë se të dy prindërit me një përqindje të njëjtë janë ushtrues të dhunës ndaj tyre.


Forma më e përhapura e dhunës psikologjike që përdoret në mjedisin familjar, të raportuar nga fëmijët në ALO 116 janë kërcënimi me fjalë, përdorimi i nofkave, të bërtiturat, mbajtja e mërisë, kërcënimi me objekte, por edhe kërcënim me braktisje dhe mallkim.

Gjithashtu fëmijët raportojnë se të shpeshta janë zënkat dhe ofendimet që kanë me vëllezërit me **19%** dhe me motrat **6%** të rasteve të raportuara.

Ndërkohë që në shkollë format më të përhapura të dhunës psikologjike me **12%** të rasteve të raportuara, janë nga mësuesit si të bërtiturat, ofendimet dhe shpesh here përdorimi i nofkave dhe epiteteve që nxënësit cilësohen si i mefshtë, toç, i/e fjetur etj.


Shpërndarja gjeografike

Shpërndarja gjeografike e telefonatave të raportuara për rastet e abuzimit emocional pranë shërbimit ALO 116 në nivel qarku janë evidentuar kryesisht: Tirana me **37** raste, Peshkopia me **26** raste, Vlora me **18** raste, Durrësi me **16** raste etj.




2.5 Abuzimi seksual

E.A"l thashë të mos më prek, por ai nuk ndaloj vazhdon të më prekte, fillova në ato momente të ndjeja neveri për kushërin tim".



Gjatë 6 viteve të punës së ALO 116 janë trajtuar gjithsej **118** raste që i referohen abuzimit seksual. Referuar këtyre të dhënave vajzat përbëjnë numrin më të madh të raportimeve me **77%** të rasteve ndërsa djemtë me **33%** të rasteve të trajtuara në shërbimin ALO 116.

Ushtruesit e dhunës



Abuzimi seksual përbëjnë edhe rastet më të vështira për t'u trajtuar në shërbimin e ALO 116 sepse fëmijët e ngacmuar seksualisht shfaqin tërheqje dhe mungesë gadishmërie për të denoncuar abuzuesit. Ata ndihen të turpëruar dhe shpesh here fajësojnë veten për atë ç'ka

ndodhur. Nga të dhënat e marra vajzat janë më të ekspozuara ndaj ngacmimeve seksuale se sa djemtë.

Kryesisht ndër format më të raportuara të abuzimit seksual janë: molestia, preket, ngacmimet, inçesti, pornografia etj. Nga raportimet e dhënave të afërmit janë abuzuesit me numrin më të madh të rasteve të trajtuara. Fëmijët vajzat janë më të ekspozuar nga abuzimi prej njerëzve që i rrethojnë, si përshembull anëtarë të familjes ose miq, njerëz që kujdesen për ta, deri edhe bashkëmoshatarë.

Në pjesën më të madhe të rasteve të raportuara në shërbimin ALO 116, fëmijët ndjehen të turpëruar dhe në siklet për të folur me prindërit e tyre mbi çështjet që lidhen me seksualitetin.

Si mund t'i përgjigjemi abuzimit seksual?

Mbi 220 milionë fëmijë janë pre e dhunës së ushtruar ndaj tyre. Kështu thuhet nga statistikat e publikuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Rezulton se çdo vit, rreth 150 milionë fëmijë, ose 14 % e popullsisë së brishtë janë viktimë e abuzimeve seksuale. Shatë për qind janë viktimë të manjakëve seksualë. Shtëpia është një vend i rrezikshëm për rreth 62 milionë vajza, të cilat martohen pa mbushur moshën të 18 –at dhe që më pas dhunohen nga partnerët e tyre.

Të gjitha format e abuzimit seksual ndaj fëmijëve shkaktojnë një dëm të rëndë shëndetit mendor dhe fizik të fëmijës. Pasojat e abuzimit seksual i ndjekin fëmijët edhe në faza të mëvonshme të jetës si të rritur – jetë që sipas përshkrimeve të viktimave, shpesh jetohet me trishtim dhe dhimbje të fshehur.

Abuzuesit e fëmijës mund ta bëjnë fëmijën që të përjetojë frikë ekstreme në rast se do ta nxjerrë sekretin. Fëmija mund të flasë vetëm kur e ndjen se është i/e rrethuar nga një mjedis, i cili beson dhe e mbështet. Nëse një fëmijë thotë se është i ngacmuar, prindërit duhet të përpiqen të qëndrojnë të qetë dhe ta risigurojnë fëmijën se gjithçka çfarë ka ndodhur nuk ka qënë për faj të tij/saj.

Të rriturit mund të mos ndjehen të përgatitur dhe të mos dine se çfarë të thonë në rast se fëmijët e tyre ju tregojnë se janë abuzuar ose ngacmuar seksualisht. Më poshtë janë listuar disa sugjerime nga ALO 116 kur trajton këtë formë të dhunës.


Çfarë duhet thënë? Nëse një fëmijë tregon në një mënyrë të mjegullt se ka ndodhur abuzimi seksual, ai duhet inkurajuar që të flasë lirshëm. Çdo koment vlerësues apo paragjykses do ta dëmtojë procesin.

- ✓ Fëmijës i duhet treguar se ju e kuptoni dhe se për ju është serioze gjithçka që ai/ajo ju thotë. Psikologët dhe psikiatrit e fëmijëve dhe adoleshentëve kanë treguar se ata të cilët dëgjohen

dhe merren seriozisht nga të rriturit në momentin e rrëfimit kanë një ecuri më të mire në trajtimin e çrregullimeve që vijnë si pasojë e abuzimit.

- ✓ Fëmija duhet të marrë sigurinë, se fakti që ka treguar se çfarë ka ndodhur është gjëja e duhur. Një fëmijë që është afër me abuzuesin mund të ndjehet i frikësuar nëse abuzuesi e ka kërcënuar në rast të nxjerrjes së sekretit.
- ✓ Fëmija duhet të dëgjojë se ajo çfarë ka ndodhur nuk është për faj të tij. saj. Shumica e fëmijëve viktime të abuzimit seksual mendojnë se ata janë shkaktarët e tij apo e përceptojnë abuzimin si një formë ndëshkimi për faj të vetin.
- ✓ Fëmijët kanë nevojë të ndjehen të mbështetur si dhe të sigurohen që do të merren masa që abuzimi do të ndalë.

Shpërndarja gjeografike



Shpërndarja gjeografike e telefonatave të raportuara për rastet e abuzimit seksual pranë shërbimit ALO 116 në nivel qarku janë evidentuar kryesisht: Tirana me **22** raste, Durrësi me **12** raste, Peshkopia dhe Korça me **10** raste, etj.

2.6 Neglizhimi


Në shërbimin e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, një qytetare nga qyteti S. telefonojë në ALO 116 për të denoncuar rastin e një familje nga fshati Z. i qytetit B. Në një nga vizitat e saj në fshatin e prindërve, ajo është njohur me historinë e tre vajzave të cilat jetonin vetëm në një shtëpi të shkatërruar dhe në kushte të mjerueshme.

Vajzat janë të moshës 3 vjeç e gjysëm, 8 dhe 11. Prindërit e tyre janë ndarë para disa kohësh dhe kujdestarinë e fëmijëve me vendim të gjykatës e ka fituar i ati i vajzës. Megjithatë fëmijët jetojnë vetëm. I ati i vajzave bashkëjeton me një grua tjetër, ndërsa nëna e vajzave jeton në fshatin e prindërve të saj në një tjetër qytet.


Nëna e vajzave ka tentuar t'i marrë me vete fëmijët e saj por ish bashkëshorti ia ka rimarrë sërish. Edhe pse i ati ka kujdestarin e vajzave ato qëndrojnë vetëm në shtëpi duke u kujdesur për njëra – tjetrën, ndërkohë që i ati i viziton ato 1-herë në javë.

Vajzat jetojnë në kushte të mjerueshme dhe në kushte të vështira ekonomike. Ato kanë disa krerë bagëti dhe sistematikisht kujdesen vetë për to duke i nxjerrë në kullotë. Ata nuk përfitojnë ndihmë ekonomike. Askush në zonën ku ato jetojnë nuk kanë reaguar ndaj kësaj ngjarje pasi i tremben reagimit të babit të vajzave.

Gjatë 6 viteve të punës së ALO 116 janë trajtuar gjithsej **178** raste që i referohen abuzimit emocional. Referuar këtyre të dhënave vajzat përbëjnë numrin më të madh të raportuara me **55%** të rasteve ndërsa djemtë me **45%** të rasteve të trajtuara në shërbimin ALO 116.




Neglizhuesit



Nga të dhënat e raportuara në ALO 116 fëmijët tregojnë se në mjedisin familjarë të tyre neglizhohen më tepër nga nënat me **35%** dhe baballarët me **32%** të rasteve. Ndër format e neglizhimit të raportuara nga fëmijët i referohemi mungesës së plotësisht të nevojave bazë, si kujdes shëndetësor, veshmbathje, ushqyerje, ndihmë në vazhdimësin e arsimit, mungesë të ngrohtësisë dhe mbështetje. Por edhe vëllezërit dhe motrat nuk mbeten mbrapa në manifestimin e sjelljeve neglizhuese ndaj fëmijëve.

Shpërndarja gjeografike





Shpërndarja gjeografike e telefonatave të raportuara për rastet e neglizhimit pranë shërbimit ALO 116 në nivel qarku janë evidentuar kryesisht: Tirana me **35** raste, Elbasani me **16** raste, Vlora me **16** raste, Berati me **15** raste etj.

Dhuna ndaj fëmijëve në shkollë

2009 - 2014

3. Dhuna ndaj fëmijëve në mjediset e shkollës

Që në shkollën fillore kam vuajtur bulizmin, sidomos nga djemtë. Cdo ditë shkoja në shkollë me frikën se djemtë do më ngacmonin, do më thërrisin pederast, froço etj. Më shumë kam vuajtur nga mësuesja e anglishtes e cila më fliste me kunja ditën kur Klodi i Big Brother u deklarua. Një ditë, një grup prej rreth 15 djemsh, më rrahën duke më bërë lojën e shkrepses më të shkurtër”.



968 rasteve të raportuara i përketin kategorisë dhunë ndaj fëmijëve në mjediset e shkollës. Nënkatëgoritë më të raportuara për të cilën fëmijët dhe adoleshentët kanë kërkuar ndihmë dhe këshillim janë bulizmi me **410** raste si dhe problemet me mësuesit me **558** raste të raportuara.

Për nënkategorinë e Bulizmit **58%** janë raportuar nga telefonues të gjinisë mashkullore dhe **42%** të gjinisë femërore. Nënkategoria e dytë Probleme me mësuesit, **52%** janë raportuar nga telefonues të gjinisë mashkullore dhe **48%** të gjinisë femërore.

Gjatë këtyre viteve tek ALO 116 janë adresuar një sërë shqetësimesh dhe problemesh që fëmijët dhe të rinjtë kanë hasur në institucionet arsimore në lidhje me shkeljen e të drejtave të tyre. Fëmijët raportojnë se ofendimet, sharjet, shkulja e veshit e në raste të caktuara ndonjë shpullë, vijnë të përdoren nga mësuesit si format më të shpeshta në disiplinimin e nxënësve të arsimit parauniversitar. Më i raportuar ky fenomen paraqitet në zonat urbane, dhe kryesisht në shkollat 9-vjeçare.

Një ndër problemet më shqetësuese të raportuara në ALO 116 është dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve. Çdo ditë fëmijë nga e gjithë Shqipëria telefonojnë pranë ALO 116 duke treguar frikën e tyre për të dalë nga shtëpia. Bulizmi është një problem që prek shumë fëmijë në mjedise të ndryshme. Megjithëse prindërit, mësuesit, dhe të rriturit nuk e shohin gjithmonë atë, ata nuk mund të kuptojnë se si sharjet, fyerjet, ofendimet, konfrontimi fizik që fëmijët kanë ndërmjet tyre mund të marrë përmasa ekstreme.

Disa nga format e bulizimit të raportuara në ALO 116 janë:

- Bulizimi verbal është forma më e zakonshme e raportuar nga fëmijët. Përfshin trajtimin ofendues, talljet, mendimet raciste paragjyquese, etj
- Bulizimi Fizik: përfshin dhunën fizike të një personi apo një grup adoleshentësh kundrejt shokëve të tyre. Përfshin sjellje të tilla si pickimi, rrahja me shkelma, shkulja e flokëve, shtyrja etj.

“B është një djalë 10 vjeç i cili karakterizohet nga një tip i turpshëm, i rezervuar, i mbyllur. Një grup prej djemsh 3 vjet më të mëdhenj prej ditësh e ngacmojnë, e pickojnë dhe e rrahin me shkela për t’i marrë lekët që prindërit i japin me vete çdo mëngje kur shkonë në shkollë”.

- Bulizimi Indirekt përfshin përhapjen e thashethemeve, gjykimeve, ofendimeve për një person të caktuar me qëllim lëndimin e tyre.

“E. është një vajzë 12 vjeç e cila ka kohë që në një grup vajzash tek klasa e tyre e tallin dhe e vënë në lojë pasi ajo është e shëndosh dhe si rrjedhim vajza ndihet shpesh vetëm dhe e përjashtuar nga grupi shoqëror”.

Paraqitja e jashtme dhe statusi social janë dy nga faktorët kryesor që ndikojnë në fenomenin e bulizmit. Bulizmi ndodh me ata fëmijë të cilët ngacmuesit mendojnë se nuk përshtaten në shoqëri, ndoshta për shkak të asaj se si ata i shikojnë këta fëmijë, se si ata veprojnë (për shembull, fëmijët që janë të trembur dhe të tërhequr), për shkak të racës apo fesë, ose për shkak se ka një orientim ndryshe seksual. Disa ngacmues sulmojnë fizikisht Të tjerët e përdori përdorin presionin psikologjik apo fyerjet verbale për të vënë veten në krye, ose përhapin thashetheme mbi viktimën.

Dhuna dhe problemet e fëmijëve në mjedisin familjar


2009 - 2014

4. Dhuna dhe problemet e fëmijëve në mjedisin familjar

Familja është njësia bazë e shoqërisë dhe mendohet si mjedisi më i sigurt që mund të ketë fëmija, por shpesh herë ai kthehet në një vend më të pasigurt për fëmijën, ku vetë familjarët ushtrojnë dhunë.. Dinamikat e vështira brenda familjes krijojnë një mjedis jo të shëndetshëm për rritjen e fëmijeve. Raportimet e marra nga fëmijët tregojnë se ata bëhen objekt i konflikteve ndërmjet prindërve, shfrytëzohen nga të rriturit për arsye përfitimi ose jetojnë me prindër që kanë varësi ndaj substancave.

“Zonja me inicialet Z.B ka telefonuar në ALO 116 ndjehej shqetësuar për mënyrën se si po sillej me fëmijët e saj. Ajo tregon që vetë ka kaluar një fëmijëri të vështirë pasi në familjen ku është rritur është dhunuar dhe rrahur sistematikisht nga prindërit, vëllezërit dhe motrat më të mëdha se ajo. Tregon se në fëmijëri është abuzuar seksualisht nga një fqinj.

Zonja Z. shprehet se ndodhje në një gjëndje të rënduar emocionale si pasojë e marrëdhënies jo të mire bashkëshortore dhe kjo situatë po ndikon në marrëdhëniet që ajo ka me fëmijët e saj. Ajo tregon se i godet shpesh fëmijët dhe grindet shpesh me bashkëshortin në prezencën e tyre.



Shpërndarja gjeografike e telefonatave

Qarku/Problematika	<i>Punë e fëmijes në shtëpi</i>	<i>Prinder të divorcuar</i>	<i>Konfliktet prind-fëmijë</i>	<i>Probleme me vellezerit dhe motrat</i>	<i>Prindër me varësi ndaj substancave</i>
Berat	2	11	99	9	5
Peshkopi	6	10	86	14	20
Durres	6	12	73	23	5
Elbasan	5	25	100	32	6
Fier	4	21	70	7	9
Gjirokaster	3	11	57	12	4
Korce	6	20	97	10	17
Kukes	3	8	21	5	3
Lezha	2	13	30	5	4
Shkoder	4	30	64	20	9
Tirane	9	49	243	46	24
Vlore	3	29	87	31	11

Nga 1703 e rasteve të raportuara i përkasin dhunë ndaj fëmijëve në mjediset familjare. 42% janë raportuar nga telefonues të gjinisë mashkullore dhe 58% të gjinisë fëmërore. Konfliktet prind – fëmijë/ të ndarë ose në konflikt janë më tepër të raportuara nga fëmijët pranë shërbimit ALO 116. Vajzat priren të raportojnë më tepër ato problematika të cilat kanë të bëjnë me shqetësimet familjare si dhe rastet kur ushtrohet dhunë ndaj tyre.

Disa nga motivet e ushtrimit të dhunës në familje të raportuara nga fëmijët janë:

- Shkaqet individuale që kanë të bëjnë me problemet e personalitetit si varsia emocionale, kontrolli i dobët i vetes, xhelozia, mungesa empatisë.
- Proçesi i socializimit që ka të bëjë me modelet e prindërimit, numrin e madh të fëmijëve, ndërhyrja në jetën e çiftit, kufizimet për të bërë një jetë normale.
- Shkaqet social-ekonomike varfëria dhe papunësia, niveli i lartë i stresit, niveli arsimor, izolimi social, prindërim i vetëm, tradhëtia, abuzimi me substancat.

Sfida dhe Rekomandime

5. Sfida dhe Rekomandime

5.1 Sfida

- Vendi ynë ende vuan mungesën e shtrirjes së plotë të shërbimeve dhe përkujdesjes sociale ndaj fëmijëve në shumë zona të ndryshme të vendit. Sipas raportimeve të ardhura në ALO 116, shumë raste të referuara nuk kanë marrë ndihmën që ju nevojitet në zonën ku ata jetojnë;
- Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur cilësinë e shërbimeve, ka mungesa të qendrave të emergjence ku fëmijët mund të strehohen në rastet e dhunës apo formave të tjera të abuzimit. Shumë raste janë referuar tek shërbimi ALO 116 duke kërkuar ndihmë për një strehim të menjëhershëm;
- Realiteti dëshmon qartë mungesën e shërbimeve në qendra shëndetësore si dhe kujdesit shëndetësor veçanërisht në zona rurale të vendit tonë. Jo pak herë në ALO 116 janë raportuar kushtet ekstreme në qendrat shëndetësore apo mjedise të papërshtashme për të ofruar ndihmën e nevojshme;
- Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të mirëkordinuara për të zgjidhur çështjet e dhunës ndaj fëmijëve;

5.2 Rekomandime

- Qeveria duhet të marrë në konsideratë mbështetjen e ALO 116, si një shërbim unik në ndihmë të fëmijëve;
- Qeveria duhet të integrojë pikëpamjet e fëmijëve në politikat qeveritare. Të gjithë departamentet dhe strukturat e ngritura nga qeveria në shërbim të përmirësimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve duhet të reflektojnë qasjen e fëmijëve ndaj këtyre strukturave;
- Të ngrihen protokolle të posaçëme, për identifikimin, menaxhimin dhe trajtimin profesional të rasteve të dhunës ndaj fëmijëve;
- Qeveria duhet të rrisë buxhetin për shërbimet në mbrojtje të fëmijëve;
- Të rritet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të pushtetit qendror, vendor dhe organizatave të shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve multidisiplinare për fëmijët;

- Të krijohet një rrjet partnerësh që do të jenë mbështetës të vazhdueshëm shërbimeve të emergjencës në ndihmë të fëmijëve. Ky partneritet është i nevojshëm jo vetëm për të identifikuar nevojat që fëmijët dhe adoleshentët kanë, por edhe për të rritur cilësinë e shërbimeve të ofruara;
- Qëndërzimi i shërbimeve nëpërmjet krijimin të rrjetit do të krijojë mundësinë për identifikimin dhe krijimin e një harte të burimeve kryesore që mund të jenë potencialisht të vlefshëm për t'i ardhur në ndihmë të gjithë atyre individëve që mund të ndodhen në vështirësi në një moment të caktuar;
- Të bëhet fushatë më e gjerë për ndalimin e të gjitha formave të ndëshkimit trupor të fëmijëve në shtëpi dhe në mjediset e përkujdesjes;
- Të zhvillohen fushata ndërgjegjësuere për prindërit me qëllim njohjen e tyre me praktikat më të mirë të mirërritjes së fëmijëve;

BLINI MJETET E KANCELARISE PER ZYREN TUAJ ME LOGON E ALO 116!

Të dashur miq të ALO 116,

ALO 116- Linja e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim 24 orë/7 ditë të javës, i dedikuar për të gjithë fëmijët në Shqipëri që ofron këshillim, referim të rasteve dhe informim për fëmijë dhe prindër. ALO 116 është një nga linjat e këshillimit më të reja në Europë. Vazhdimësia e saj dhe e shërbimit që ofron Linja varen nga bashkëpunimi dhe kontributi i anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë.

Në Dhjetor 2011, UNICEF na ndihmoi që të prodhojmë një sërë produktesh kancelarie dhe për përdorim personal për shitje me logon e ALO 116, nën moton "Unë mbështes ALO 116". Qëllimi i shitjes së tyre është mbështetja e vazhdimësisë së shërbimit të ALO 116. Shitja e këtyre objekteve bëhet përkundrejt dokumentacionit të rregullt. Të gjitha të ardhurat nga shitja shkojnë për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit të ALO 116 përgjatë vitit 2015-2016.

Lista e sendeve në shitje është: stilolapsa të thjeshtë, stilolapsa për fëmijë, hapëse zarfash, orë tavoline, çanta pëlhere për pazar, kalema, bllok shënimesh i ricikluar, axhenda, filxhan i madh, kapela, çanta shpine për fëmijë, varëse çelësash dhe çadra shiu.

Nëse keni mundësi, që kur bëni blerje kancelarie për zyrën, konferenca, trainime apo projektet tuaja, ne do ju luteshim që të merrnit në konsideratë edhe blerjen e objekteve të kancelarisë me logon "Në mbështetje të Alo 116". Kjo do të ishte një mbështetje e jashtëzakonshme për Alo 116 dhe shërbimin që ne ofrojmë për fëmijët anembanë Shqipërisë. Pagesat mund të bëhen në cash, bankë dhe kartë krediti (Visa / American Express).

Për çdo pyetje ose porosi që mund të keni, ju lutem kontaktoni:

Znj. Rezearta Gjalpi

Menaxher ALO 116

Cel: 0672075332

E-mail: rezarta.gjalpi@crca.al



ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës i cili ofron:

- Dëgjim aktiv të fëmijëve
- Këshillim psikologjik
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqendrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

ALO 116 mbështetet nga:



dhe këto kompani të telefonisë në Shqipëri:

